

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA MEKANIKE BUJQËSORE "HASAN D. GINA" LUSHNJË

AGJENCIA KOMBËTARE E
PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
Nr. 3377 Prot.
Datë, më 10.11.2023

Nr. 599 prot.

Lushnjë më 09.11.2023

Lënda: Njoftim për vend të lire

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË Ë MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr.14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",

Ofruesi publik i AFP-së.shkolla mekanike bujqesore "Hasan D. Gina" Lushnje, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

Mesimdhënes i teorise profesionale Dega Sherbime Mjete Motorike (me kohe te plote)

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vend të lire si vijon:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a. letërmotivimin për pozicionin;
- b. jetëshkrimin (CV-në);
- c. kartën e identitetit;
- d. diplomën;
- e. librezën e punës;
- f. çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV-ne;
- g. certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h. vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i. vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j. vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi.
- k. të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;
Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 20.11.2023

DREJTORI I SHKOLLES

Ardian PRIFTI

